

REZOLUTË
PËR VLERËSIMIN E VEPRIMTARISË SË KOMISIONIT
QENDROR TË ZGJEDHJEVE
PËR VITIN 2015

Kuvendi i Shqipërisë:

- Vlerëson se ushtrimi i funksioneve nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për mbajtjen e zgjedhjeve të lira, demokratike, të ndershme dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare është me rëndësi vendimtare për garantimin e të drejtave themelore dhe konsolidimin e shtetit të së drejtës.

- Duke konsideruar se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është organi më i lartë i përhershëm shtetëror, i ngarkuar për administrimin e zgjedhjeve dhe shpalljen e rezultatit të tyre;

- Duke mbajtur në konsideratë se veprimtaria e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duhet të udhëhiqet nga parimet e integritetit, të paanësisë, të pavarësisë politike dhe institucionale, të transparencës, e të profesionalizmit;

- Duke besuar në rëndësinë e bashkëpunimit dhe bashkërendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në procesin e reformës zgjedhore dhe duke vlerësuar rolin e saj në këtë proces të pritshëm të ndryshimeve të Kodit Zgjedhor;

Kuvendi i Shqipërisë shqyrtoi raportin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve mbi veprimtarinë e tij gjatë vitit 2015 dhe shqetësimet e shfaqura në zgjedhjet lokale të vitit 2015. Në referim të çështjeve të ngritura për:

- Bashkëpunimin me organet e qeverisjes vendore, në funksion të organizimit dhe administrimit të zgjedhjeve;

- Procesin e regjistrimit të partive politike;

- Procedurat e ngritjes dhe funksionimit të KZAZ-ve;

- Problemeve që ndikuan në zgjatjen e procesit të numërimit;

Kuvendi i Shqipërisë konstaton se:

- Gjatë vitit 2015 Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ka realizuar përgjithësisht kërkesat dhe detyrat e lëna nga Kuvendi, me rezolutën për vlerësimin e veprimtarisë së institucionit, të vitit të kaluar, për fokusimin në një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me zgjedhjet vendore të vitit 2015;

- Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, gjatë vitit 2015, ka organizuar zgjedhjet lokale në kushtet e funksionimit të një ligji të ri për ndarjen e re territoriale dhe pas amendamenteve të bëra në Kodin Zgjedhor;

- Problematikat e referuara nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të shërbejnë për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe si çështje orientuese për zgjedhjet e ardhshme.

- Viti në vazhdim nuk është vit zgjedhor, ndaj Komisioni Qendror i Zgjedhjeve duhet të fokusohet në drejtimet administrative, që përshtaten dhe realizohen më mirë në një vit jozgjedhor, siç është viti 2016.

Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve fokusimin në:

- Marrjen e masave, nëpërmjet mekanizmave dhe sipas procedurave buxhetore, për të përmbyllur pajisjen me infrastrukturën ndihmëse, logjistike dhe pajime për mjediset e reja të institucionit, përpara mbylljes së vitit në vazhdim.

- Vendosjen në funksionim të Qendrës së Trajnimeve Zgjedhore edhe me mbështetjen e donatorëve, partnerë të KQZ-së, të hartojë programet e trajnimit dhe të nisë ciklin e parë të trajnimeve brenda vitit 2016.

- Organizimin dhe vënien në zbatim të planit të bashkëveprimit me njësitë e qeverisjes vendore, për identifikimin, këqyrjen, vlerësimin dhe unifikimin e përmbajtjes së praktikave zyrtare dhe dokumentacionin e qendrave potenciale të votimit, në bashkëpunim dhe nën përgjegjësinë e kryetarëve të bashkive, përpara mbylljes së vitit në vazhdim.

- Bashkëveprimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile me të cilën:
 - Të marrë në shqyrtim problematikën e vërejtur lidhur me listat e zgjedhësve;
 - Të shqyrtojë e të monitorojë masat e marra nga administrata e gjendjes civile;
 - Të përpunojë rekomandime për rregullimet dhe përditësimin e regjistrave, si dhe t'i bëjë ato publike përpara mbylljes së vitit në vazhdim.
- Përditësimin e bazës së të dhënave për personat që nuk shikojnë, si dhe të personave në tërësi me pengesa në aftësinë për votim, duke marrë masa për sa i përket informimit, edukimit dhe përfshirjes së përfaqësuesve të tyre në këtë trajtim të teknikës zgjedhore, përgjatë vitit në vazhdim deri në zgjedhjet e radhës.
- Vazhdimin e hartimit dhe zbatimit të programeve dhe projekteve të posaçme për pakicat kombëtare me programe informimi, edukimi dhe përfshirjen e përfaqësuesve të pakicave në trajtimin e çështjeve zgjedhore, përgjatë vitit në vazhdim deri në zgjedhjet e radhës.
- Kuvendi i Shqipërisë nxit Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të hartojë dhe të zbatojë programe dhe projekte njohëse për përdorimin e teknologjive të votimit apo numërimit në votim, të identifikojë teknologji premtuese dhe të adaptueshme në realitetin shqiptar të zgjedhjeve, duke i bërë të njohura për faktorin politik dhe publikun, përgjatë gjithë vitit në vazhdim dhe në vijimësi.
- Kuvendi i Shqipërisë vlerëson të dobishme fillimin e një vlerësimi të plotë nga ana e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për votimin e shtetasve shqiptarë që jetojnë dhe punojnë në emigracion, me synim lehtësimin dhe garantimin e së drejtës kushtetuese të tyre për të votuar.
- Kuvendi i Shqipërisë i kërkon Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të vendosë në dispozicion të Komisionit të Reformës Zgjedhore informacionin, dijet dhe eksperiencën teknike të përftuar si eksperiencë nga zgjedhjet e mëparshme.

Miraturar në datën 28.4.2016

KRYETARI
Ilir Meta